

Pasqyra e lëndës

Hyrje	11
DIDAKTIKA DHE GJITHËPËRFSHIRJA SHKOLLORE	
Debati mbi gjithëpërfshirjen shkollore në Itali	17
Një bilanc pas më shumë se tridhjetë vitesh nga Ligji 517/1977	17
Logjika shumëfishe e mbështetjes	25
Dimensioni gjithëpërfshirës i didaktikës	29
Didaktika dhe didaktikat: në kërkim të plotësueshmërisë	29
Kur didaktika merr një drejtim gjithëpërfshirës?	31
Didaktika drejt procesit të të nxënit dhe proceseve të gjithëpërfshirjes.	37
Një vend për ndërmjetësit	
Didaktika laboratorike si mënyrë për të nxënë	45
Nga libri tek dërrasa interaktive: në mes të teknologjive të vjetra dhe të reja	50
Nga praktika tek praktika e mirë: cilat janë kërkesat?	52
«TË NJOHËSH VETVETEN PËR TË VETËPROJEKTUAR».	
NJË KËRKIM ME PJESËMARRJE PËR NJË BASHKËNDARJE PRAKTIKASH	
Qasja metodologjike e kërkimit me pjesëmarrje	59
Kërkimi me pjesëmarrje	59
Kërkimi me pjesëmarrje «Të njohësh vetveten për të vetëprojektuar» të shkruarit si takim	65
Metodologjia, qëllimet dhe objektivat e kërkimit	65
Pjesëmarrësit	69
Fazat operative	70
Instrumentet	71
Dy instrumente për thellim	75
Analiza dhe interpretimi i të dhënave	77
Proceset gjithëpërfshirëse dhe dinamikat sociale në klasa	77
Opinionet dhe qëndrimet kundrejt gjithëpërfshirjes shkollore	86
Proceset gjithëpërfshirëse, dinamikat sociale në klasë dhe praktikant	92
Vlerësimi përfundimtar dhe vlerësimi mbas një viti	98
Përsiatje përfundimtare	99
Proceset e gjithëpërfshirjes dhe treguesit didaktikë	107
Treguesit për përkufizimin e një didaktike gjithëpërfshirëse	107
Bibliografia	115

Hyrje

Gjithëpërfshirja nuk është një proces që lind dhe zhvillohet në mënyrë spontane, por ka nevojë për një pikënisje të studiuar, e cila mund të realizohet duke i qëndruar besnik disa premisave pedagogjike të pakundërshtueshme; është edhe një didaktikë, e vetëdijshme dhe e menduar, e strukturuar sipas këtyre parimeve pedagogjike, që mund të ndihmojë në promovimin e gjithëpërfshirjes, prandaj, duhet që proceset të cilat lidhen me gjithëpërfshirjen të sintonizohen me qëllimin didaktik të mësuesve, të cilët parapërgatisin, përshtatin, krijojnë, rimodelojnë kontekste të nxëni për t'i bërë ato të dobishme.

Të pranosh se proceset që lidhen me gjithëpërfshirjen duhet të vihen në jetë me mençuri, parakupton domosdoshmërinë e një qëllimi projektues nga ana e mësuesve, të cilët synojnë të nxisin evoluime dhe ndryshime tek nxënësit, veçanërisht tek ata me aftësi të kufizuara, për t'i bërë kompetentë. Kur kompetencat lindin në kontekste të nxëni ku mbizotëron pjesëmarrja dhe marrëdhëniet mes subjekteve të përfshira, në të njëjtën kohë, favorizohet përvetësimi nga ana e nxënësve i kompetencave shoqërore, të cilat janë të domosdoshme, më pas në moshë madhore, për një përfshirje të vlefshme në botën sociale.

Kjo perspektivë ka nevojë për përparime dhe suksese graduale, të lidhura me të nxënësit, përmes të cilave nxënësi të mund të përkufizojë doradurës identitetin e një personi aktiv, të aftë dhe në rritje dhe, kjo mund të arrihet me ndërmjetësinë e një didaktike të strukturuar në mënyrë të përshtatshme dhe të qëllimshme, për të favorizuar një zhvillim progresiv e të vetëdijshëm të vetë personit në tërësinë e tij.

Sukseset dhe arritjet në shkollë krijojnë tek nxënësit vullnetin dhe dëshirën për të eksperimentuar dhe provuar veten në zhvillime të tjera të hapura ndaj mundësive dhe arritjeve të reja. Sot, nuk mjafton të kënaqesh me arritjen e një qëllimi sepse është më e rëndësishme të mbash gjallë dëshirën për të arritur të tjera synime, pra, duke u hapur, gjithnjë ndaj mundësive të reja.

Kur ekzistenca vetjake është e lidhur me aftësinë e kufizuar është e lehtë ta humbasësh këtë shtysë dhe vetëmbyllja mund të bëhet e pashmangshme në atë se çka kjo aftësi e kufizuar priret të fshehë dhe të ku-